



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE

Durrës më \_\_. \_\_. 2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**BLERJE MATERIALE KANCELARIE DHE TË NGJASHME**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Pajisje zyre përveç mobiljeve 30191000-4

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

7.999.967,23 (Shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nënëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje njëzet e tre) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

**Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Sipas nenit 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Çertifikatë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)**, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neneve 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

AK, bazuar në dispozitat më sipër cituar dhe kërkesat e specifikimeve teknike, dhe preventivit të furnizimieve, ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit (Certifikatat ISO) dëshmues të pajtueshmërisë së ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. Certifikatat ISO të kërkuara nga AK lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikën e furnizimit të shtjelluara dhe zgjidhura në preventivin përkatës.

Në vijim shtjellohen certifikatat ISO të kërkuara nga AK.

**ISO 9001:2015.** Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë".

ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et e prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi për produktin:

- (Nr:1) Leter A4 80g/m<sup>2</sup>,
- (Nr:28) Flash driver 64 GB me skanim të shenjës së gishtit ,
- (nr:29) Flash driver 128 GB me skanim të shenjës së gishtit
- (Nr:47) Grirese letre,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Vendosija e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

**2.4.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim/deklaratë/autorizim nga prodhuesi ose të distributorit të autorizuar për /artikullin

- (Nr:1) Leter A4 80g/m<sup>2</sup>,
- (Nr:28) Flash driver 64 GB me skanim të shenjës së gishtit ,
- (nr:29) Flash driver 128 GB me skanim të shenjës së gishtit

- (Nr:47) Grirese letre”.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Vertetimet/deklaratat/autorizimet duhet të përmbajnë të dhëna të plota si: telefoni/e-mail/website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

AK gjykon se kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

**2.4.3** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë duhet që ditën dhe orën e hapjes së ofertave, të paraqesin mostra për artikujt me nr rendor: Rendor 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 16, 21, 22, 24, 26, 28, 51. *Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, ato janë përzgjedhur për artikujt që kanë sasi të konsiderueshme të cilët janë më të kërkuarit.

Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve

(ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit

**Lista e materialeve:**

NR	Mostra	PERSHKRIMI	Njesia	Sasia
1	PO	Leter A4 e bardhe 80gr/m2	rizma/500fl	2,000
2		Leter A3 e bardhe 80gr/m2	rizma/500fl	50
3	PO	Zarfa plasmasi me vrima A4 100 micron. Pako me 100 cope.	Pako	1,800
4		Dosje me kuti me mekanizem 5cm	cope	200
5	PO	Dosje A4 plastike, me llastik dhe klip (kapesë)	cope	500
6		Dosje me buton 7-9 cm kartoni	cope	50
7	PO	Dosje me unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza. Ne brendesi dosja te permbaje xhep per leter A4 dhe bllok A4, mbajtjese stilolapsi dhe minimumi 3 xhepa te vegjel .	cope	400
8		Dosje plastike me min 80 qese brenda me kuti	cope	50
9	PO	Dosje me buton, plastike ose ekuivalent rezistente ndaj lageshtires, me gjeresi min 20 cm, me doreze dhe me xhep per etikete shenimesh .	cope	1,000
10		Stilolapsa cilesor ngjyre blu 0.7mm	cope	100
11	PO	Rapidograf, me majë të hollë 0.3-0.4mm, ngjyre blu. Të mos zbehet dhe të mos lëshojë njolla.	cope	5,000
12		Lapsa plumbi	cope	200
13	PO	Marker I zi permanent	cope	1,000
14		Marker komplet me 4 ngjyra te ndryshme per table shenimesh	Kuti/4cp	200
15		Ndarese plastike 45x12mm ( ±2%), me min 5 ngjyra te ndryshme nga minimumi 25 flete.	cope	300
16	PO	Leter shenimesh me ngjitje permasa min 76mm x 76mm ( ±2%), me min 7 ngjyra te ndryshme, minimumi 280 fl.	cope	500
17		Korrektor stilo	cope	200

18		Makine Llogaritese Profesionale me permasa minimumi 205mm x 160mm x 40mm ,me cels per ndezje.	cope	30
19		Gershere te mesme minimumi 16.5cm	cope	50
20		Heqese telash stapleri	cope	40
21	<b>PO</b>	Makine kapese per dokumenta 23/23	cope	150
22	<b>PO</b>	Tela makine 23/23	cope	500
23		Vinovil 100gr shishe	cope	50
24	<b>PO</b>	Zarfa A4 me fluska ajri brenda	cope	7,000
25		Kapak plastik per CD-DVD	cope	500
26	<b>PO</b>	Toner per Printer HP Pro LaserJet MFP M225dw, 2200 kopje. PN CF283X/ CF283XC.	cope	150
27		Leter Rrula kase fiskale (dimension i gjere 11 cm)	pako/10 cp	300
28	<b>PO</b>	Flash driver 64 GB me skanim te shenjes se gishtit (min 6 shenja) . Garanci "Lifetime"	cope	100
29		Flash driver 128 GB me skanim te shenjes se gishtit (min 6 shenja).Garanci "Lifetime"	cope	100
30		Bateri per telekomande AA 1.5v LR6 ( e madhe )	cope	200
31		Bateri per telekomande AAA 1 .5v LR03 ( e vogel )	cope	200
32		Skoc letre (gjeresi 50mm-52mm dhe gjatesi minimumi 50 m)	cope	50
33		CD-RW 4X-12X, 700MB, pako me 50cp	pako	20
34		Vizore Plastike 30 cm	cope	50
35		Kapese aktesh me veshe 32 mm 12 cope/pako	pako	150
36		Kapese aktesh me veshe 51 mm 12 cope/pako	pako	50
37		Kapese aktesh me veshe 67 mm 12 cope/pako	Pako/12cp	50
38		Maus Optical USB	cope	30
39		Tastier USB	cope	30
40		Blloqe Flete Dalje	cope	300
41		Blloqe Flete Hyrje	cope	150
42		Liber Magazine min 200 faqe 24 cm*17 cm	cope	100
43		Makine kapese te medha, per 240 flete	cope	50
44		DVD+R 16X 4.7GB, pako me 10cp	pako	20



45		Evidenciator	cope	100
46		Tastier + Mous bluetooth kit	SET	10
47		Grirese letre	cope	10
48		Pinca rrjeti cilesore	cope	6
49		Universal Cutter Stripper for Flat or Round UTP Cat5 Cat6	cope	6
50		Koka kabull interneti platike	cope	300
51	<b>PO</b>	Libreze uji	cope	100,000
52		SSD i jashtem 1TB	cope	20
53		Set skrivanie lekure ose druri, me minimumi 9 pjese te ndryshme ( tapet tavoline, orë, mbajtese per letra A4, per fletepalosje, per letra shenimesh, per stilolapsa, per kapese aktesh, stilolaps, etj). Te gjitha pjeset te jene me material dhe dizenjo te njejte.	cope	20
54		Tapet mouse (Mousepad) qe pershtatet me formen e kycit te dores.	cope	40
55		Makina lidhese me spirale teli, hapi 2:1. Hap min. 25fl njeheresh, lidh min.280 flete.	cope	5
56		Tabele e bardhe magnetike e emaluar, me permasa minimumi 90cm X 120cm.	Cope	4
57		Power bank	Cope	15
58		Kabull USB-C to USB-A	Cope	40
59		USB type A Charger Block 20W 3.0 Compact Fast Charger	Cope	40
60		Mbajtese dokumentash metalike me 4 sirtare, me celes.	Cope	40
61		Kosh letrash metalike	Cope	40
62		Njesi shperndarese e rrymes zgjatues prize me min 8porta dalese AC, min 2 porta USB	Cope	20
63		Cante laptopi shpine 15.6-17" e zeze	Cope	4
64		Kabull vga/vga	Cope	20
65		Kabull DVI/VGA	Cope	10

### Specifikimet e letrës:

1	Pesha per letren A4 te bardhe	Sipas pershkrimit perkates ne tabele.
2	Lagështia	3-4.5 %



3	Trashësia	103-112 $\mu\text{m}$
4	Drita	$\geq 93\%$
5	Shkëlqimi	101-115 %
6	CIE Bardhësia	jo me e vogel se 148%
7	Ashpersia (aftësia) në përkulje MD : $\geq 100 \text{ mNm}$	
8	Ashpersia (aftësia) në përkulje CD : $\geq 35 \text{ mNm}$	
9	Përmasat e letrës A4 210*297 mm	
10	Letra A4 të mos shkaktojë bllokimin e makinës fotokopjuese/printerin	
11	Të qëndrojnë e rrafshët pas kopjimit/printimit	
12	Të mos lëshojë pluhur letre në makinën fotokopjuese/printer	
13	Të jetë e lëmuar dhe e rëndë	
14	E përshtatëshme për printim në të dy anët	
15	Të përballojë shpejtësinë e printimit jo më pak se 120-130 faqe në minutë	
16	Nuk pranohet leter e ricikluar.	
17	Të plotësojë standartet ISO 9706 ose ekuivalente, standart që plotëson kushtet për letrat që mbahen për një kohë shumë të gjatë në arkiva	

1	Pesha per letren A3 te bardhe	Sipas pershkrimit perkates ne table.
2	Lagështia	3-5 %
3	Trashësia	103-112 $\mu\text{m}$
4	Drita	$\geq 93\%$
5	Shkëlqimi	101-115 %
6	CIE Bardhësia	jo me e vogel se 148%
7	Përmasat e letrës A3 420*297 mm.	
8	Letra A3 të mos shkaktojë bllokimin e makinës fotokopjuese/printerin	
9	Të qëndrojnë e rrafshët pas kopjimit/printimit	
10	Të mos lëshojë pluhur letre në makinën fotokopjuese/printer	
11	Të jetë e lëmuar dhe e rëndë	
12	E përshtatëshme për printim në të dy anët	
13	Të plotësojë standartet ISO 9706 ose ekuivalente, standart që plotëson kushtet për letrat që mbahen për një kohë shumë të gjatë në arkiva	
14	Ashpersia (aftësia) në përkulje MD : $\geq 100 \text{ mNm}$	
15	Ashpersia (aftësia) në përkulje CD : $\geq 35 \text{ mNm}$	
16	Nuk pranohet leter e ricikluar.	

### Specifikimet e tonerave:

- Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës

- Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit.
- Tonerat të jenë të shoqeruara me pulle sigurie nga prodhuesi ose ekuivalente të tyre dhe me part number-at e kerkuara nga AK. Emri i prodhuesit të jetë i stampuar në kutinë e bojës (dhe jo me etikete), në pullën e sigurisë dhe në kartrixhe , dhe të jetë i njëjti emër prodhuesi në paketimin e bojës, në pullën e sigurisë dhe në kartrixhe.
- Numri serial i kutisë duhet të jetë i njëjtë me numrin serial të bojës.
- Bojrat duhet të jenë origjinale ose ekuivalente, të pershtatura për llojet e printerave , të mos jenë të rimbushura (Recondition); të mos jenë të ricikluara (Remanufactured); të mos jenë të riproduhuara; të jenë të paketuara e të pahapura.

#### **Specifikimet e Grijës së letres:**

- Niveli I Sigurisë: min P-4
- Dimensioi i prerjes së letres: prerje terthore (Cross Cut) 4x40mm
- Sasi e letres së prere njekohesisht: 25-30 fije
- Volumi I koshit: min 210 litra
- Te Grije gjithashtu: kredit karta, kapese, tela, CD
- Te jete me vajosje automatike ( Auto oiler)
- Dimensioi: Gjatesi x gjerësi x thellesi (H x W x D): 900mm-980mm x 600mm-660mm x 500mm-600 mm

#### **Specifikimet e Tabeles së bardhe magnetike e emaluar(Nr.56):**

- Tabele e bardhe magnetike e emaluar, me permasa minimumi 90cm X 120cm
- Te shkruhet në të dyja anet me marker dhe të fshihet, me rrotullim 360° dhe me sistem kyçjeje të pjesës magnetike .
- Te ketë të inkorporuar mbajtjese për aksesore.
- Te jete me rrota rrotulluese që mbyllën (fiksohen) .

#### **Specifikimet e Power bank(nr.37):**

Kapaciteti: min.30000 mah me 65W USB-C Charger 3.0

Te ketë: min.2 porta të dyfishta USB-C

Te ketë: min.2 portat e dyfishta USB-A

**Lëvrimi i mallit do të jetë 30 ditë nga lidhja e kontratës.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke***

**argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*